



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SPITALI RAJONAL DURRËS

NR. Prot _____

Data 29.05.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Procedure e Hapur /mallra– Prokurim me mjete Elektronike”.

Blerje materiale ortopedike dhe traumatologjike per Spitalin Rajonal Durres – Marreveshje kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 muaj.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor *Spitali Rajonal Durres* ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a) Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 29 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e parashikuar se: 1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH. 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

b) Lista e cmimeve te artikujve, sipas Shtojces 2;

Argumentimi: Kjo shtojce eshte pjese e setit te dokumenteve standarte te tenderit per proceduren e prokurimit te sipercituara.

c) Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83/1 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Si dhe Nenit 83/2 ku përcaktohet se: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

d) Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për

pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 KAPACITETI EKONOMIK DHE FINANCIAR:

a) Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël **40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, pra jo më e vogël se 13.977.114 leke**, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

ARGUMENTIMI: Ky kriter u vendos në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", pika 4:

“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

Gjithashtu, eshte vene ne perputhje me nenin 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, pika 4:

*[...]4. Për të provuar **përvojën** e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se **40% të vlerës së përlogaritur të kontratës**, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit*

në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvajave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 4 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvajën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se **40 %** të vlerës së fondit limit të lotit apo shumës së loteve, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

b) Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, AK kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare **(2020, 2021 dhe 2022)**.

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë vlerën e përllogaritur të kontratës pra të vlerës **34.942.785 leke**, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

ARGUMENTIMI: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, pika 3:

“Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një **xhiro** vjetore minimale të caktuar.*

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

*Në rastin e kontratave që bazohen në një **marrëveshje kuadër**, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

Gjithashtu, është vënë në përputhje me nenin 43 të VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, pikat e mëposhtme:

”1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të **xhiros** vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e **xhiros** minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.
5. Në rastin e kontratave që bazohen në një **marrëveshje kuadër**, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve të kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros minimale vjetore nuk mund të tejkalojë vlerën e perlllogaritur të kontrates në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, bazuar në pikën 2/b të nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Duke qene se kjo procedure prokurimi eshte ne vleren **34.942.785 leke** pa tvsh, vlere kjo qe eshte ndërmjet kufirit të lartë monetar (40.000.000 leke) dhe kufirit të ulët monetar (10.000.000 leke), atehere gjendemi në kushtet e nenit 43 pika 2/b e VKM-se 285/2021.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenin 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.

c) Autoriteti kontraktor vlereson të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancin e tyre vjetor, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare (**2020, 2021 dhe 2022**), që të tregoj raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Duke qene se kerkohet nje bilanc, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin e njerit prej viteve të mesiperme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

ARGUMENTIMI: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, pika 3:

“Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

*...Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në **bilancet** e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.”*

Gjithashtu, është vënë në përputhje me nenin 43 të VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” pika 4:

*“Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në **bilancet** e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa*

konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.”

2.2 KAPACITETI TEKNIK:

a) **Vetedeclarim** i operatorit ekonomik lidhur me origjinën e mallit, ku te percaktohet qarte vendi dhe kompania prodhuese.

ARGUMENTIMI: Kjo kerkese vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion. Ky kriter është ne perputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe keto kerkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses te kontrates pra te garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

b) Ofertuesi duhet të jetë i çertifikuar me **çertifikatë** ISO 9001:2015 ose ekuivalente per tregëtim të materialeve mjekesore (ne rast se ofertuesi është prodhues i artikujve të ofruar).

Në rast se ofertuesi nuk është prodhues i artikujve te ofruar duhet te paraqese **vetedeclarimin** se prodhuesi është konform sistemeve te menaxhimit te cilesise dhe i njeh te drejten AK per te verifikuar vetedeclarimin ne procesimin e vleresimit te dokumentacionit, dhe ne rast se OE do te shpallet fitues do te paraqese **çertifikaten** ne fjale e cila duhet te jete e vlefshme.

ARGUMENTIMI: Ky kriter vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020 ”Per Prokurimin Publik”, ne te cilen gjejme te percaktuar se:

Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter gjën mbështetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar ku percaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

c) **Vetedeclarim** se te gjitha materialet nga ofertuesi jane konform Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, **bashkëlidhur** me kopjet e **çertifikatave** përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave.

ARGUMENTIMI: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3.4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se Çertifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë **autorizim** nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për Shqipërinë, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar per periudhen që përfshin objekti i prokurimit.

Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar për Shqipërinë të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës.

ARGUMENTIMI: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Duke qene se behet fjale per tregitim te mallrave ne vendin tone, atehere dokumenti shoqerues qe e verteton kete fakt eshte pikerisht autorizimi nga prodhuesi i mallrave / distributor i autorizuar nga prodhuesi, per lejimin e tregëtimin te artikujve te tij. Autorizimi nga Prodhuesi është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues (*Per me teper ref.Vendim i KPP nr.353/2014*). Gjithashtu vendosja e ketij kriteri gjen mbeshtetje edhe tek pika 4, neni 77, e Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” si dhe ne rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve per kualifikim ne dokumentat e tenderit te procedurave te prokurimit publik”. Per sa me siper cituam, cmojme se kerkimi i dokumentit qe parashikohet ne piken ç) te kapacitetit teknik eshte ne perputhje me ligjin perkates per barnat

e) **Deklarate** qe verteton se operatori ekonomik disponon te gjithë sasine per secilen nga materialet e kerkuara nga AK dhe do ta vere ne dispozicion te Autoritetit sipas kerkesave te ketij te fundit, **si dhe** do të vërë në dispozicion për çdo operacion që do të kryhet, setet e montimit (minimumi 1 set montimi) dhe të paktën një specialist të trajnuar për përdorimin e seteve.(te pakten nje mjek/ infermier instrumentar te trajnuar per perdorimin e seteve). Në deklaratë duhet të tregohet emri i specialistit/eve dhe duhet te kete **bashkelidhur Certificate/Deshmi** te leshuar nga kompanite prodhuese te seteve qe te provojne trajnimet e tij si dhe **Licensen** e Ushtrimit te Profesionit te mjekut/infermierit.

Sqarim: Kerkohet mjek ose infermier (instrumentar) pasi shpesh here eshte e nevojshme qe infermieri te jete i pranishem ne sallen e operacionit per vendosjen e seteve.

ARGUMENTIMI: Ky kriter vendoset ne mbeshtetje te pikes 2 dhe 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, pikes 3 dhe 5 te nenit 40 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, dhe behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pasjes se burimeve/kapaciteteve te mjaftueshme per furnizimin me sasine dhe llojin e kerkuar nga AK dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar ne DST.

f) Kërkohen të paraqiten **katalogë** teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT.)

ARGUMENTIMI: Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë

dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;

g) Kërkohen të paraqiten **mostra** për të gjithë artikujt e ofruar.

Procedura e dorëzimit të mostrave është si me poshte:

Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Spitalit Rajonal Durres, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të kësaj procedure prokurimi ne oren dhe ne daten e hapjes se tenderit.

-Se bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një **shkrese** të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen ne zarf/kuti.

-Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të çmimit.

-Ne paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qarte origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi ne formularin e çmimit.

-Ne rast se OE do të shpallet fitues duhet të pajisi secilin nga artikujt e ofruar me të paktën tre barkode adezive.

-*Sqarim:* Ky kriter vendoset për arsye sepse barkodet perdoren nga stafi mjeksor për dokumentat personale te pacientit.

Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuar sipas Nr. Rendor të formularit të çmimit, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçante ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të s’kualifikohet.

ARGUMENTIMI: Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: “a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;”.*

Paraqitja e mostrave per artikujt qe jane objekt prokurimi, eshte kerkuar me qellim verifikimin e perputhshmerise ne vend te materialeve mjekesore qe operatori ekonomik oferton me specifikimet teknike te percaktuara ne DST ne Shtojcen 5, dhe duke qene se ato kane nje natyre te vecante, per te bere te mundur vleresimin e tyre eshte i nevojshem testimi i tyre ne Sherbimi Ortopedik.

Keto kritere dhe argumentime jane bere dhe vendosur ne baze te materialit te pergatitjes se specifikimeve teknike me nr. 213/10 prot., dt. 22.05.2023 te pergatitur nga grupi i punes i ngritur me urdherin e brendshem me nr. 681/1 prot., dt. 03.05.2023.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

GRUPI	ARTIKULLI	SPECIFIKIME TEKNIKE	Njesia	sasia e pritshme per 2023-2024
Materialet e ortopedise te jene te gjitha titan				
PLLAKA				
1	Pllake klavikule	Pllake klavikule anatomike superiore anteriore e majte dhe e djathte per vida 3.5mm jo locking dhe locking me gjatesi 95-120 mm me tolerance +/-10%	cope	2
2	Pllake Kerciri anatomike auto-kompresive per vida 4.5mm	Pllaka duhet te kete gjatesi nga 100mm deri 330mm me nje tolerance +/- 10%.	cope	2
3	DHS/DCS	Pllake DHS/DCS jo locking me kende 95° 130, 135, 140, 145 dhe 150°, me gjatesi variabel nga 48mm deri 370mm me tolerance +/-10%. Gjatesia e vides qendrore te varioje nga 50mm deri 150mm me tolerance +/-10%. Pllaka duhet te jete e vlefshme per kontakt te limituar. Vida kompresive me gjatesi 25-32mm.	cope	100

4	Pllake Fibule	Pllake 1/3 Tubulare me gjatesi te ndryshme nga 70mm deri ne 140mm me devijacion +/-10%.	cope	20
5	Pllake Radiusi dhe Ulnë	Pllake anatomike Radiusi dhe Ulnë me gjatesi nga 92mm ne 242mm per vida 3.5mm me devijacion +/-10%. Pllake anatomike distale volare e majte dhe e djathte me gjatesi 55mm deri 77mm me devijacion +/-10%. Pllake volare distale ekstra artikulare e majte dhe e djathte me gjatesi 47mm dhe 67mm me devijacion +/-10%.	cope	10
6	Pllake anatomike Piloni	Pllaka duhet te jete ne formen e terfilit me gjatesi 86mm-205mm per vida 3.5 mm dhe 4.0 mm me devijacion +/-10%.	cope	4
7	Pllake suprakondilare Humerale	Pllaka te jete ne formen e ypsilonit me 12 vrima per vida 3.5mm dhe 4.0mm.Deviacion +/- 10%	cope	4
8	Pllake Platoje Tibiale	Te jete e tipit T dhe L te majta dhe te djathta me gjatesi 65mm-180mm me devijacion +/-10%.	cope	6
9	Pllake anatomike humeri proksimal (jo locking)	Pllake anatomike proksimale humeri jolocking e majte /e djathte per vida 3.5mm/4.00mm me 4 deri 10 vrima e gjatesi 85mm- 160mm deviacion +/- 10%	cope	4
10	Pllake anatomike femuri proksimal	Pllake anatomike femuri proksimal te jete e majte dhe e djathte me nje gjatesi 100mm deri ne 350 mm me tolerance +/- 10%.	cope	2
11	Pllake anatomike femuri distal	Pllake anatomike femuri distal te jete e majte dhe e djathte me nje gjatesi 130mm deri ne 350mm me tolerance +/-10%.	cope	2
12	Pllake distale humerale latero-dorsale	Pllake humerale laterodistale e majte/djathte per vida 2.7/3.5/4.0 mmme 3-14 vrima e gjatesi 60mm- 200mm deviacion +/-10%	cope	1
13	Pllake Olekrani (Jo Locking)	Pllake olekrani jolocking per vida 3.5mm me shume vrima e gjatesi 75mm-135mm deviacion +/- 10%	cope	4
14	Pllake Kalkanëare	Pllaka e modelueshme me shume vrima per vida 3.5mm e 4.0mm, Deviacion +/- 10%	cope	1
SHTIFTE TE SHULUARA (INTERLOCKING NAIL)				
1	Shtifte tibiale	Shtiftet tibiale të kenë 4 përmasa nga 8mm deri në 11mm gjerësi dhe për secilën përmasë të ketë përmasa në gjatësi që fillojnë nga 260mm deri ne 400mm, me devijacion +/-10%.	cope	15

2	Shtifte femorale	Shtiftet femorale të jenë të përshtatshëm për frakura femorale dhe ato trokanterike, te ketë 4 përmasa nga 9mm deri në 12mm gjerësi, ku secila përmasë të ketë përmasa në gjatësi që fillojnë nga 340mm deri në 460mm, me devijacion +/-10%.	cope	15
3	Shtif humerusi	Shtiftet humerale të kenë 4 përmasa nga 6mm deri në 9mm gjerësi dhe për secilën përmasë të ketë përmasa në gjatësi që fillojnë nga 180mm deri në 300mm, me devijacion +/-10%.	cope	10
4	Vida për shulim (locking screw)	Vidat duhet të jenë me përmasat kompatibel me shtiftin, me gjatësi nga 26 deri në 80mm.Deviacion +/-10%	cope	160
Sistemi për vidat distale të shtiftit intramedular (në përdorim)				
SHTIZA ELASTIKE (TENS)				
1	shtizat elastike	Shtizat duhet të jenë elastike me diametër 2.0mm deri në 4.0mm dhe të kenë gjatësi nga 300mm në 400mm	cope	20
Sistemi për vendosjen e shtizave elastike (në përdorim)				
VIDA				
Të gjitha përmasat e vidave janë me devijacion +/- 10%				
1	Vida kortikale auto-filetante 3.5mm	Vida kortikale auto-filetante 3.5mm me gjatësi nga 12mm-15mm.	cope	300
2	Vida spongiotike 4.0mm	Vida spongiotike 4.0mm me gjatësi nga 12mm-50mm.	cope	30
3	Vida të kanjuluara 4.0mm	Vida të kanjuluara 4.0mm me gjatësi nga 20mm-70mm.	cope	20
4	Vida kortikale 4.5mm	Vida kortikale 4.5mm me gjatësi nga 16mm-90mm.	cope	700
5	Vida spongiotike 6.5mm	Vida spongiotike 6.5mm me fileto të plotë (full-threaded), me gjatësi nga 50mm-120mm.	cope	100
6	Vida spongiotike 6.5mm	Vida spongiotike 6.5mm me fileto të pjesshme (partially-threaded), me gjatësi nga 50mm-120mm.	cope	50
Vida të kanuluara (cannulated screw)				
7		vida të kanjuluara D7.3mm dhe gjatësia 40-140mm, pjesërisht të filetuar (partially thread) 32mm	cope	25

8		vida të kanjuluara D7.3mm dhe gjatësia 40-140mm, pjesërisht të filetuar (partially thread) 16mm	cope	25
FIKSATORE				
Fiksatorët të jenë në dy ose tre versione, të shkurtër, standart dhe të gjatë.				
Fiksator ekstern multiaxial me klamp				
1		a)Fiksator ekstern Humerusi	cope	1
2		b)Fiksator ekstern Radio-Carpal	cope	1
3		d)Fiksator Femuri	cope	1
4		f)Fiksator Piloni	cope	1
PROTEZA				
1	Komponenti Femoral pa cement	Stemi femoral duhet të jete me dy lloje offset: standart dhe I lateralizuar; Seria të kete jo me pak se 10 permasa per stemin standart dhe 10 permasa per stemin e lateralizuar me një gjatesi 132 mm deri ne 180 mm me një devijacion maksimal+/-10%; komponenti femoral të kete permbajtje Titanium alloy. Konusi I qafes duhet të jete 12/14, STEMI STANDART të kete një kend cerviko-diafiziar 130 – 135 grade +/-10% ndersa STEMI I LATERALIZUAR të kete një kend cerviko-diafiziar 123-135 grade +/- 10%. Duhet të jene pa kollare dhe të jete lehtësisht I ekstradueshem ne rast rezizionimi.	cope	30
2	Komponenti Femoral me cement	Stemi femoral me cement duhet të jete me dy offsete: standart dhe I lateralizuar, të kete perberje Co-Cr os SS ose IMG. Konusi I qafes të jete 12/14 dhe kendi cerviko-diafiziar të jete 130-135 grade +/-10% per STEMIN STANDART dhe 123-135 grade +/-10% per STEMIN E LATERALIZUAR. Stemi femoral duhet të kete të pakten 6 permasa me një gjatesi 135 mm deri ne 160 mm me një devijacion maksimal +/-10%.	cope	10
3	Komponenti acetabular pa cement	Shelli të kete perberje titanium alloy dhe të kete të pakten 13 permasa qe fillojne nga 40mm deri ne 64mm. Te kete tre vrima periferike dhe një qendrore ne pjesen e brendshme të cilat sherbejne per fiksimin e komponentit me kocken ne saje të vidave ku rrisin stabilitetin primar. Te kete të pakten tre elemente sigurie fiksimi ku të pakten njera prej tyre të jene vidat. Polietileni perkates i komponentit acetabular duhet të jete dy llojesh: standart dhe me antiluxim, 10-20 grade. Diametri i tij i jashtem duhet të pershtatet diametrit të brendshem të shellit kurse diametri i brendshem i polietilenit duhet të jete 28mm ose 32mm, Komponenti acetabular duhet të shogerohet	cope	10

		me vida perkatese qe fillojne nga 15-50 mm, Deviacion +/- 10%		
4	Kokat Femorale	Kokat Femorale te jene me perberje CoCr ose qeramike. Koni i brendshem te jete 12/14. Diametri duhet te jete 28mm dhe 32 mm me te pakten 5 permasa: small, medium, large, extralarge, extraextralarge.	cope	40
5	Koka Bipolare	Perberja e siperfaqes se kokes bipolare te kete perberje CoCr ose Stainless Steel. Seria te filloje nga numri 41mm dhe te vazhdoje ne menyre lineare deri ne numrin 58mm me devijacion +/- 10%.	cope	30
6	Endoproteza parciale mono-blok ose Austin Moore	Proteza parciale mono-blok duhet te ketë stemin 130-150mm të gjatë me kënd 135 gradë dhe të fillojnë nga përmasa 38mm deri në 55mm. Materiali mund te jete stainless steel Deviacion +/- 10%	cope	50
7	Cementi Kockorë	Cementi per kocken duhet te jete ne paketime nga 40g dhe te jete ne variantet: te kete ne perberje te tij nje antibiotik te tipit gentamicin, te jete pa antibiotik ne rast se pacienti eshte alergjik nga antibiotiku. Afati i skadences ti kaloje 1(nje) vit.	cope	50
Te tjera				
1	Shtiza Kirschner	Shtiza Kirschner 1.0-2.0 mm dhe te jene ne me dy gjatesi 150 mm e 300 mm. Deviacion +/- 10%	cope	200
2	Shtiza Steinman	Shtiza Steinman te jene ne tre permasa ne diameter 2.5mm, 3.0mm, 3.5mm e 4.0mm e gjatesi nga 270 mm deri 300 mm, Deviacion +/- 10%	cope	50
3	Tel per sinteze	∅1.5mm, ∅1.8mm, ∅2.0mm	cope	1
4	rende (washer)	Te pershtatshme per vida 35mm /4.0 me devijacion +/- 10%	cope	20
		Te pershtatshme per vida 4.5mm me devijacion +/- 10%	cope	20
		Te pershtatshme per vidat 6.5mm/7.3mm +/- 10%	cope	20

Argumentimi per specifikimet teknike eshte bere **ne baze te materialit te pergatitjes se specifikimeve teknike me nr. 213/10 prot., dt. 22.05.2023 te pergatitur nga grupi i punes i ngritur me urdherin e brendshem me nr. 681/1 prot., dt. 03.05.2023**, si dhe ne perputhje me nenin 4, pika 38 te Ligjin nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe neneve 20 dhe 49 te Ligjit nr. 105/2014 "Per Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik".

ARGUMENTIMI I FONDIT LIMIT:

Ky argumentim eshte bere **ne baze te materialit te pergatitjes se specifikimeve teknike me nr. 213/10 prot., dt. 22.05.2023.**

Per llogaritjen e fondit Grupi i punes i **ngritur me urdherin e brendshem me nr. 681/1 prot., dt. 03.05.2023** eshte bazuar ne VKM-ne 285 datë 19/05/2021 sipas nenit 76 /1 sipas te cilit:

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatoreve ekonomik

Gjithashtu është bazuar edhe ne korrespondencat elektronike ndermjet OE per marrjen e ofertave per pergatitjen e fondit limit.

Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës Blerje materiale ortopedie dhe traumatologjie per 1 vit, sipas studimit te tregut si me poshte:

Ne percaktimin e sasive te materialeve te nevojshme, komisioni u bazua ne parashikimin e bere nga Shefi i Sherbimit te Ortopedise sipas shkreses me Nr. 213/6 prot, date 04.04.2023 “Kerkese per materiale ortopedie dhe traumatologji per vitin 2023 – 2024”.

U ngarkua ne sistemin e prokurimit elektronik nga njesia e prokurimit: